



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE MITROVICË

Numri i lëndës: 2024:039625

Datë: 12.03.2025

Numri i dokumentit: 06977893

C.nr.331/2024

GJYKATA THEMELORE NË MITROVICË, si gjykatë civile e shkallës së parë, e përberë nga gjyqtari individual Skender Shala, në çështjen juridike kontestimore te paditëses E.P. nga Komuna e Mitrovicës, të cilën sipas autorizimit më shkrim e përfaqëson Zehra Verbovci avokate nga Mitrovica, kundër të paditurit IKSHPK në Prishtinë të cilin sipas autorizimit më shkrim e përfaqëson Ministria e Drejtësisë - Avokatura Shtetërore, me objekt kontesti “*kompensimi të pagesës së shpërblimit jubilar*”, vlera e kontestit 425 euro (*katërqind e njëzet e pesë euro*), më datë 12.03.2025, jashtë seancës nxjerr këtë:

A K T G J Y K I M

- I. APROVOHET kërkesëpadia e paditëses E.P. nga Mitrovica, kundër të paditurës IKSHPK në Prishtinë, si e bazuar;
- II. OBLIGOHET e paditura IKSHPK në Prishtinë që paditëses E.P., në emër të pagesës së shpërblimit jubilar, t’ia kompenzoj shumën e përgjithshme prej 425 (*katërqind e njëzet e pesë*) euro.
- III. DETYROHET e paditura që paditëses, shumën sikurse në pikën II të dispozitivit t’ia paguaj edhe kumatën ligjore prej 8 % (*tetë për qind*), duke llogaritur nga data 23.01.2024, datë e paraqitjes së padisë në gjykatë, e deri në pagesën përfundimtare, të gjitha këto (borxhin kryesor dhe kumatën prej 8 për qind) në afat prej 7 (*shtatë*) ditësh nga dita e marrjes së këtij aktgjykimi, nën kërcënim të përmbarimit të detyrueshëm.
- IV. OBLIGOHET e paditura IKSHPK në Prishtinë që në emër të shpenzimeve procedurale, t’ia kompensoj paditëses

shumën e përgjithshme prej 98 (*nëntëdhjetë e tetë*) euro, në afat prej 7 (*shtatë*) ditësh, nga dita e pranimit te aktgjykimit, nën kërcënimin e përmbarimit te dhunshëm.

### *A r s y e t i m*

Paditësja nëpërmes të autorizuarit të saj më datën 23.01.2024 ka ushtruar padi, më të cilën ka kërkuar shpërblimin jubilar për 10 (*dhjetë*) vjetorin e dytë të përvojës së punës dhe atë në shumën e përgjithshme prej 425 (*katërqind e njëzet e pesë*) euro, duke u bazuar në Kontratën Kolektive Sektoriale të datës 11.06.2018.

Sipas përshkrimit në padi, paditësja në padi thekson se është në marrëdhënie pune tek e paditura që 20 (*njëzet*) vite radhazi dhe se e njëjta akoma vazhdon me ushtrimin e profesionit të saj në të njëjtin vend pune. Në shkresat e lëndës është bashkëngjitur edhe kërkesa e paditëses drejtuar të paditurës, kërkesë kjo për kompensimin e pagës për shpërblim jubilar për dhjetëvjetorin e dytë, më pas listën e pagave të lëshuar nga Buxheti i Republikës së Kosovës me nr.10-71100-206-0740, me të cilin vërtetohet se paditësja realizon të ardhura nga marrëdhënia e punës tek e paditura.

Paditësja para se gjithash i është drejtuar të paditurës me kërkesë për kompensimin e një page bazë në emër të shpërblimit jubilar, mirëpo nga shkresat që gjinden në lëndë, rezulton se tani e paditura nuk ka kthyer përgjigje në kërkesën e parashtruar, gjë e cila i ka dhënë shkas parashtrimit të padisë.

Nga provat e administruara si më lartë, u vërtetua gjendja faktike nga e cila gjykata gjeti se kërkesëpadia e paditëses është e drejtë dhe e bazuar si për nga lartësia ashtu edhe për nga baza, sepse gjatë shqyrtimit gjyqësor u vërtetua se ndërmjet paditësve dhe të paditurës ka ekzistuar (dhe vazhdon) marrëdhënia e punës.

Po ashtu u vërtetua fakti se paditësja kishte punuar te e paditura dhe ende vazhdon të punoj, dhe të njëjtës nuk i është paguar kompensimit në emër te pagave të shpërblimit jubilar, të parapara me nenin 35 paragrafi 3 nen paragrafi 2 i KKS-së, ne te cilën parashihet “*“punëtoret shëndetësor, në vitet jubilarë të punësimit përfitojnë shpërblimin jubilar nga punëdhënësi i fundit, [...] për 20 vjet të përvojës në punë në institucione shëndetësore, te punëdhënësi i fundit, në vlerë të dy page mujore të tij”*”.

Gjykata duke u bazuar në KKS, konkretisht në nenin 35 paragrafi 3 nën paragrafi 2, gjeti se e njëjta është e aplikueshme në rastin konkret dhe se e paditura ka pasur për detyrim që paditëses t'ia paguaj kompensimin në emër të pagave të shpërblimit jubilar. Shuma e aprovuar e kërkesëpadisë për paditësin, shumat si në dispozitiv të këtij aktgjykimi, i referohet provave të lartcekurës, konkretisht kërkesa e paditëses drejtuar të paditurës, kërkesë kjo për kompenzimin e pagës për shpërblim jubilar për dhjetëvjetorin e dytë dhe Listës së pagesës të lëshuar nga Buxheti i Republikës së Kosovës.

Prandaj, Gjykata iu referua Kontratës së lartëcekur, të miratuar dhe nënshkruar nga Ministria e Shëndetësisë së Republikës së Kosovës dhe Federatës së Sindikatave të Shëndetësisë së Kosovës, dispozitat e së cilës aplikohen në tërë territorin e Kosovës, në nenin 35 paragrafi 3 nën paragrafi 2 është paraparë e drejta e punëtorit në kompensimin në emër të pagesës së shpërblimit jubilar.

Gjykata i konsideron si irelevante pretendimet e përfaqësueses të së paditurës, se e kundërshton kërkesëpadinë me arsyetimin se Kontrata Kolektive Sektoriale e Kosovës ka pushuar të vlejë me datën 31.12.2017, ngaqë kjo e fundit kishte vlefshmëri deri me datën 10.06.2021, si dhe e konsideron si të pa bazë faktin se kërkesat e paditëses janë parashkruar, ngaqë paditësja ka parashtruar kërkesën brenda afatit ligjor, gjegjësisht me datën 23.01.2024 ende pa arritur periudha e parashkrimit sepse kontrata e lartëcekur ishte në fuqi deri më datë 10.06.2021. E tëra kjo arsyetohet në bazë të Mendimit Juridik të Gjykatës Supreme të Kosovës për zbatimin e Kontratës Kolektive Sektoriale lidhur me kërkesat e pagës së 13-të të punëtorëve të shëndetësisë, të datës 09 Tetor të vitit 2023.

Sipas arsyetimit të kësaj gjykate lidhur me jetëgjatësinë e Kontratës Kolektive Sektoriale të Kosovës ndër të tjerash thuhet se : *“Kontrata ka qenë në fuqi në periudhë kohore tri vjeçare dhe atë nga data 11.06.2018 e deri më datën 10.06.2021”*.

Sipas vlerësimit të Gjykatës, KKS e miratuar dhe e nënshkruar nga Ministria e Shëndetësisë së Republikës së Kosovës dhe Federatës së Sindikatave të Shëndetësisë së Kosovës me datën 11.06.2018, është e zbatueshme prej datës së nënshkrimit të saj. Tutje, në nenin 4 paragrafi 1, të KKS parashihet që *“KKS-ja gjen zbatim në rregullimin e raporteve juridike për të gjithë të punësuarit nëpër institucione shëndetësore, duke përfshirë tri nivelet e sistemit shëndetësor, atë parësor, dytësor dhe tërësor”*, dhe paragrafi 2 *“Fushë zbatimi i KKS-së ushtron efekt tek punëtorët shëndetësor dhe administrativ në institucione shëndetësore”*. Prandaj për këtë Gjykata vendosi si në pikën II të këtij Aktgjykimi.

Gjykata me rastin e vendosjes, jashtë seancës gjyqësore, si në dispozitiv të këtij aktgjykimi është bazuar në dispozitën e nenit 398 të LPK-së, e cila dispozitë përcakton *“Kur gjykata, pasi t’i arrijë përgjigja në padi, konstaton se ndërmjet palëve nuk është kontestuese gjendja faktike, dhe se nuk ekzistojnë pengesa të tjera për dhënien e vendimit meritor, atëherë ajo, pa caktuar fare seancë gjyqësore, mund ta jep aktgjykimin me të cilën e pranon si të themeltë kërkesëpadinë.”*. Ndërsa, me nenin 4 paragrafi 2 i të njëjtit ligj përcaktohet se: *“Ndryshe nga dispozita e paragrafit 1 të këtij neni, gjykata vendosë për kërkesëpadinë në bazë të veprimeve procedurale të shkruara dhe provave të administruara në mënyrë jo të drejtpërdrejtë, po që se kjo përcaktohet me ligj”*.

Tutje, neni 245 të Ligjit për Marrëdhëniet e Detyrimeve (LMD) ka paraparë se *“kreditore në marrëdhëniet detyrimore ka të drejtë që nga debitori të kërkojë përmbushjen e detyrimit, ndërsa debitori ka për detyrë përmbushjen e detyrimit në tërësi në përputhje me përmbajtjen e tij”*, prandaj Gjykata duke u nisur nga fakti se e paditura i ka mbetur borxh paditësve me aplikimin e dispozitës së lartëcekur dhe në bazë të gjendjes së vërtetuar faktike, vendosi që ta detyroj të paditurën që paditësve t’ia kompensoj borxhin në shumat e gjykuara.

Lidhur me vendosjen e lartësisë së kamatës të përcaktuar 8% (për qind), gjykata vendosi në pajtim me dispozitën e nenit 382 të LMD-së duke e llogaritur atë prej ditës e parashtrimit të padisë (03.01.2024) e deri në pagesën definitive.

Në lidhje më afatin për Ankesë prej 7 ditësh, Gjykata vendosi në bazë të nenit 476 dhe 477 të LPK-së.

Vendimi mbi shpenzimet e procedurës është marrë në bazë të nenit 452 paragrafi 1 të LPK-së, sipas të cilit pala e cila e humb kontestin ka për detyrë që palës kundërshtare të ia kompenzoj shpenzimet gjyqësore. Në rastin konkret pala e paditur ka për obligim që paditëses të ia paguaj shpenzimet e procedurës në shumën prej 78 (shtatëdhjetë e tetë) euro në emër të përpilimit të padisë dhe në emër të taksës gjyqësore shumën prej 20 (njëzet) euro.

Prandaj, gjykata bazuar në arsyet e cekura me larte si dhe duke u bazuar në dispozitat e neneve 398 lidhur me nenin 4 paragrafi 1 të LPK-së dhe nenin 245, 382 të LMD-së, vendosi si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA THEMELORE NË MITROVICË

Departamenti i Përgjithshëm – Divizioni Civil

C.nr.331/2024, më datës 12.03.2025

Gj y q t a r i

Skender Shala

*KËSHILLË JURIDIKE:*

*Kundër këtij Aktgjykimi, pala e pakënaqur ka të drejtë ankese në afat prej 7 (shtatë) ditësh, nga dita e pranimit të te njëjtit. Ankesa i drejtohet Gjykatës së Apelit të Kosovës në Prishtinë, përmes kësaj Gjykate.*